

**1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2016**

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë<sup>1</sup>.)

**1.1. Operacione të tregut të hapur**

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore			R/REPO >1javë <3muaj	Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, ndërhyrjet në tregun e parasë konsistojnë në operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit, si dhe në transaksionet e blerjeshme të drejta të plota të bonove të thesarit për portofolin e
30-.6.-16		23,600				
7.7.16		21,680				
14.7.16		27,780				
21.7.16		26,600				
22.7.16	3,000					
25.7.16	3,700					
26.7.16	3,700					
27.7.16	3,700					
28.7.16		30,200			3,000	
4.8.16		30,570				
11.8.16		25,810				
18.8.16		28,900				
19.8.16	2,500					
22.8.16	2,800					
23.8.16	2,200					
24.8.16					4,000	
25.8.16		33,020				
1.9.16		28,900				
8.9.16		27,200				
15.9.16		33,340				
22.9.16		33,000				
24.9.16					3,000	
26.9.-16					3,000	
29.9.16		20,565				

Burimi: Banka e Shqipërisë.

BSH-së, me synim zëvendësimin e portofolit të saj të shitur në tremujorin e parë të vitit 2016, si dhe uljen e përqendrimit të ekspozimeve të larta të bonove të thesarit në portofolin e Bankës së Shqipërisë.

<sup>1</sup> Shifrat janë në vlerë nominale


## Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016

Sasia totale e likuiditetit të injektuar në sistemin bankar u rrit ndjeshëm në mesatarisht 31<sup>2</sup> miliardë lekë kundrejt 18 miliardë lekëve në tremujorin e mëparshëm. Rritja e mungesës së likuiditetit ka ardhur si rezultat i maturimit të pjesshëm të marrëveshjeve *swap* midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, daljeve të *cash* – it dhe grumbullimit të likuiditetit në llogarinë e qeverisë.

Me qëllim zëvendësimin e portofolit të BSH-së për 2.1 miliardë lekë të shitur në tremujorin e parë të 2016-ës, Banka e Shqipërisë ka kryer blerje të përhershme të bonove të thesarit 12-mujore nga bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i këtyre blerjeve, në fund të periudhës, portofoli i BSH që 0.12 miliardë lekë më i ulët se në fund të vitit 2015.

Në operacionet e tregut të hapur, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, për injektim të përkohshëm të likuiditetit për mesatarisht 27.9 miliardë lekë kundrejt 17.45 miliardë lekëve në tremujorin e mëparshëm. Gjatë periudhës janë kryer edhe 4 ankande për injektime të gjata për mesatarisht 2.5 miliardë lekë që përfshinin 1 ose 2 periudha të mbajtjes së rezervës së detyruar.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë ne periudhën 2015-2016 (me vlerë nominale).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Operacioni rregullues për injektim njëditor është përdorur në 7 raste në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar për muajt korrik dhe gusht për mesatarisht 3 miliardë lekë.

### 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë periudhës janë përdorur të dy instrumentet mbështetëse të ofruara nga Banka e Shqipërisë. Depozita njëditorë është përdorur në shumat 0.4-2.9 miliardë lekë me frekuencë thujse ditore duke filluar nga mesi i

<sup>2</sup> Shifrat janë me çmim blerjeje.

## **Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016**


muajit shtator. Ndërkaq, kredia njëditore është përdorur më shpesh se një tremujor më parë në 7 raste kundrejt 3 rasteve në tremujorin e mëparshëm, por për shuma të reduktuara nga 4-7 miliardë lekë në deri në 2 miliardë lekë, kryesisht në ditët e fundit të periudhës së RD-së.

## **2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2016**

### **2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë**

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

*Grafik 2:* Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e tretë të vitit 2016



### **2.2 Veprime me institucione të tjera**

Në tremujorin e dytë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekëve midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj nëpërmjet investimit pranë BSH-së të tepricave në valutë. Në fund të tremujorit të dytë marrëveshjet e pamaturuara *swap* qenë 250 milionë euro, por ato ranë gjatë tremujorit nën vëzhgim në 210 milionë euro. Si rezultat i marrëveshjeve *swap*, blerjet e Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 90,263.2 milionë lekë dhe shitjet qenë 90,406.5 milionë lekë<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Sipas dates së kontratës.

**Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016**

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 40.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD).

*Tabelë 2:* Veprime valutore me institucione të tjera

<b>Institucioni financiar</b>	<b>Blerje të valutës (në milionë lekë)</b>	<b>Shitje të valutës (në milionë lekë)</b>
MINISTRIA E FINANCAVE	90,263.2	90,406.5
TË TJERA (IBRD)	40.00	